



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	22 - 12 2022	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jedinitca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHKIK	8374/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1070/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari-dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1070/2022 të datës 30.11.2022 e parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Komuna e Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike “shkelje e të drejtës në pagë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 22.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1070/2022 e datës 30.11.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Detyrohet Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të inicoj veprimet e nevojshme ligjore-administrative për harmonizimin e koeficientit të pagës së nëpunësit civil Fatmir Berisha nga koeficienti pesë (5) në koeficientin gjashtë (6).
- III. Obligohet Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut që të kujdeset për zbatim të vendimit sipas pikës II të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.



A r s y e t i m

Ankuesi Fatmir Berisha, i punësuar në Komunën e Mitrovicës, sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Akt emërimit të datës 29.05.2015 në pozitën Zyrtar për Arkiv 1, më datë 30.11.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 7498/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet për njohje të së drejtës për harmonizim të koeficientit të pagës nga koeficienti pesë (5) në koeficientin gjashtë (6).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 05.12.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Mitrovicës. Ndërsa Këshilli, me datë 09.12.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit me numër protokollit 7843/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 7498/2022 të datës 30.11.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesë e datës 18.11.2022 e parashtruar nga ankuesi në Njësinë e Burimeve Njerëzore për harmonizimin e koeficientit ; Përgjigje në kërkesë e datës 23.11.2022 me nr.ref 01-120/04-01035 nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore; Ndryshim dhe Plotësim Akt emërimit i datës 29.06.2015; Përgjigje në ankesë e datës 09.12.2022 nga organi i punësimit me numër protokollit 7843/2022 bashkë me shkresat e lëndës dhe Diploma e datës 01.08.2018 me nr.1302/18 e leshur nga Kolegji AAB në Prishtinë e z.Fatmir Berisha dhe ka marrë titullin Baçelor në Administratë Publike; Ndryshim dhe Plotësim i Akt emërimit të datës 01.11.2013 me koeficient gjashtë(6) për nëpunësen F.M në pozitën Zyrtare e arkivit dhe Ndryshim dhe Plotësimi i Akt emërimit të datës 01.11.2013 me koeficient gjashtë(6) për nëpunësin I. N në pozitën Zyrtar i arkivit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e bazuar, **SEPSE:**

Nga administrimi i provave të lëndës Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ankuesi sipas vendimit të datës 26.05.2015 me nr.01/112-45167/3 është transferuar në mënyrë të përhershme në pozitën Zyrtar për arkiv 1 në Qendrën për Shërbim me Qytetar në kuadër të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme nga pozita Zyrtar për protokoll dhe arkiv në kuadër të Qendrës për Punë Sociale, dhe i njëjti mbanë aktemrimin e datës 29.05.2015 me pozitë Zyrtar për Arkiv 1, më datë 18.11.2022, parashtron kërkesë te Menaxheri i Burimeve Njerëzore për harmonizim (ngritje) të koeficientit nga koeficienti pesë (5) në koeficientin gjashtë (6), ndërsa Menaxheri i Burimeve Njerëzore përmes përgjigjes me numër reference 01-120/04-0103598-2/22 të datës 23.11.2022 ka refuzuar kërkesën e parashtruar nga ankuesi me arsyetimin se nuk ka raste kur ndonjë nëpunësi civil i është ngritur koeficienti, përveç se atyre nëpunësve që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ju ka aprovuar ankesat.

I pakënaqur me përgjigjen e organit të punësimit, ankuesi me datë 30.11.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen të së drejtës për harmonizimin e koeficientit të pagës nga pesë (5) në gjashtë (6), duke u

bazuar në faktin se në institucionin ku ankuesi punon zyrtarët me pozitë të ngjashme kanë koeficientin gjashtë (6), përkatësisht ankuesi ka argumentuar këtë fakt me dy zyrtar të arkivit: F. M në pozitën Zyrtare e arkivit sipas Ndryshim dhe Plotësim i Akt emërimit të datës 01.11.2013 me koeficient gjashtë(6) dhe I. N në pozitën Zyrtar i arkivit sipas Ndryshim dhe Plotësim i Akt emërimit të datës 01.11.2013 me koeficient gjashtë(6).

Kolegji i këshillit konstaton se duke u bazuar në katalogun e titujve të vendeve të punës, pozitave e kësaj kategorie janë me gradën e vendit të punës 10 dhe me koeficient 6 ndërsa sipas nenit 34 paragrafi 3 të Rregullores Nr.05/2012 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, Institucionet e Republikës së Kosovës kanë qenë të detyruara që të bëjnë klasifikimin, harmonizimin dhe standardizimin e pozitave në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje me qëllim që të mos kemi situata të kësaj natyre me karakter diskriminues.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 19 ku përcaktohet se: *"Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave"* si dhe nenin 3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil me të cilin parashihet se: *"1. E drejta e nëpunësve civil për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil. 2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë...."*, dhe rrjedhimisht konstatohet se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësit civil të cilët kryejnë detyra të ngjashme të punës dhe që kanë kualifikime dhe përvojën e kërkuar për pozitën respektive, duhet të realizojnë pagë të njëjtë.

Andaj, në vështrim të dispozitave ligjore si me lartë bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se organi i punësimit respektivisht Komuna e Mitrovicës së Jugut lidhur me pozitën Zyrtar i Arkivit 1 si pozita të kategorisë së njëjtë aplikon koeficient të ndryshëm të pagës, gjegjësisht Kolegji nga provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës ka konstatuar se pozitave të njëjtës kategori në të njëjtin institucion kanë koeficient 6, kështu që bazuar në këto fakte Kolegji vlerëson se aplikimi i koeficienteve jo të njëjtë të pagës për pozita të kategorive të njëjta, paraqet trajtim jo të barabartë dhe diskriminues të stafit brenda institucionit të njëjtë punëdhënës ashtu siç është përcaktuar me nenin 4 paragrafi 1 Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi ku thuhet se: *"Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji"*, rrjedhimisht në vlerësimin e Kolegjit trajtimi jo i barabartë dhe diskriminues i të punësuarve të njëjtit institucioni në kuptim të së drejtës së pagës është në kundërshtim të plotë edhe me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit për Zyrtarët Publikë me të cilin është përcaktuar se: *"1. Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mos diskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë..."*, andaj mbi këto baza ligjore kolegji konstaton se pretendimi i ankuesit në këtë kuptim është i bazuar.

Nga sa u tha më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se organi i punësimit konkretisht Kryetari i Komunës së Mitrovicës Jugut dhe Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore i të njëjtit institucion janë të obliguar që konform këtij vendimi dhe dispozitave ligjore në fuqi të ndërmarrin veprimet ligjore me qëllim që të bëjnë harmonizimin e koeficientit për ankuesin nga pesë (5) në gjashtë (6).


Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1070/2022, datë 22/12/2022

Sabile Avdyli



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet;

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

